



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 682 Prot.

Tiranë, më 26 / 04 / 2021

V E N D I M

Nr. 68 , Datë 26 / 04 / 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 37 Regj., datë 16.03.2021<sup>1</sup>, të S. Xh, kundër Bashkisë Fier, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “bindjeve politike<sup>2</sup>” dhe “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, S. Xh, është kryefamiljar dhe familja e tij përbëhet prej 4 (katër) anëtarësh, nga të cilët vetëm bashkëshortja punon në një fasoneri dhe të ardhurat e tyre financiare janë gjithsej 26000 lekë. Fëmijët janë në moshë madhore por të pa punësuar. Ai shprehet se që prej vitit 2013 i është ndërprerë ndihma ekonomike dhe për herë të fundit ka aplikuar pranë Zyrës së Bashkisë Fier për përfitimin e saj, në muajin shkurt 2020, por nuk ka marrë asnjë përgjigje deri më sot lidhur me arsyet se përse i është refuzuar dhënia e kësaj ndihme.

Po ashtu, subjekti ankues, ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë nga ky Institucion edhe përse i takon refuzimit dhe mospërfshirjes së tij si kryefamiljar, në programet e strehimit të Bashkisë. Ai ka pretenduar se nuk është trajtuar në mënyrë të drejtë për përfitimin nga projekti për banesat sociale të Bashkisë. Z. Xh citon se, aplikimin e fundit për përfitimin nga programet e strehimit të Bashkisë e ka bërë në muajin tetor 2020 por nuk ka asnjë njoftim për ecurinë dhe trajtimin që i është bërë kërkesës së tij. Ankuesi ka pretenduar se, është përjashtuar qëllimisht nga ofrimi në mënyrë të barabartë me gjithë qytetarët e tjerë, i shërbimeve sociale nga ana e Bashkisë,

<sup>1</sup> Plotësuar nga ankuesi me datë 08.04.2021.

<sup>2</sup> Referuar Kartës së Anëtarësimit në PD, ankuesi provon bindjet e tij politike të ndryshme nga Kryetari i Bashkisë Fier.

<sup>3</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

vetëm për faktin se është i anëtar i partisë politike/Partia Demokratike dhe bindjet e tij të djathta janë të njohura.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Bashkisë për shkaqet e pretenduara, si dhe përfitimin e ndihmës ekonomike e përfitimin nga programet e strehimit.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së<sup>4</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

---

<sup>4</sup>Shkurtesë për ligjin *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 490/1 prot., datë 30.03.2021 nga ana e KMD-së i është kërkuar informacion shtesë subjektit ankues<sup>5</sup>, në kuadër të sqarimit të pretendimeve të tij lidhur me momentet e aplikimeve përkatëse pranë Bashkisë Fier.
  - Në përgjigje të kërkesave të KMD-së, ankuesi ka parashtruar se, për herë të fundit ka aplikuar për përfitimin nga skema e ndihmës ekonomike në muajin nëntor 2020 dhe për përfitimin nga programet e strehimit në muajin tetor 2020, por që nuk disponon dokumentacionin provues.
2. Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 490/2 prot, datë 09.04.2021, nga ana e KMD-së i është kërkuar informacion Bashkisë Fier, si palë kundër së cilës është paraqitur ankesa, lidhur me pretendimin e ankuesit.
  - Në përgjigje të shkresës së KMD-së, Bashkia Fier informon si më poshtë citohet:

*“Rasti në fjalë është sa i njohur, aq dhe problematik për ne. Edhe pse z. Xh është sqaruar në portal, por edhe disa herë nga ana jonë, përsëri vazhdon me kërkesa të çuditshme dhe të pakuptimta.*

*Zotëria nuk ka aplikuar për ndihmë ekonomike. Aplikimi i fundit ka qenë muaji maj 2017, dhe për rrjedhojë duke mos aplikuar nuk mund të shpallet as fitues, as të përfitosh ndihmë ekonomike. Dhe jo vetëm kaq, por nuk është paraqitur në Njësinë Administrative, qoftë edhe për t’u sqaruar. Bashkia nuk i ndan shërbimet ndaj qytetarëve të saj sipas bindjeve politike”.*

Bashkia Fier i ka bashkëlidhur shkresës përgjigjet shkresore drejtuar ankuesit, lidhur me kërkesat e paraqitura prej tij me datë 26.01.2021 dhe datë 05.03.2021.

Nëpërmjet shkresës me nr. 769/1 prot., datë 03.02.2021 Bashkia Fier ka informuar ankuesin si më poshtë:

*“Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 26.01.2021, sikurse jeni sqaruar disa herë edhe përmes portalit ku keni bërë ankesë, se ndihma ekonomike përfitohet duke aplikuar në Njësinë Administrative ku keni pasaportizimin. Shkoni aplikoni nga data 01 deri me datë 10 të çdo muaji, dhe është sistemi ai që ju bën vlerësimin”.*

Nëpërmjet shkresës me nr. 2084/1 prot., datë 12.03.2021 Bashkia Fier ka informuar ankuesin si më poshtë:

*“Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 05.03.2021, sikurse jeni sqaruar disa herë edhe përmes portalit ku keni bërë ankesë, për problematikat që ngrini, nuk zgjidhet problemi duke bërë ankesa apo duke sharë me një fjalor banal, por duke aplikuar në sistem për ndihmën ekonomike, si dhe duke plotësuar dokumentacionin për banesë apo për bonus qeraje”.*

---

<sup>5</sup> Në vijim, për shkak të kthimit të zarfeve në adresë të ankuesit, nga shërbimi postar, me shënimin “adresë e pasaktë”, komunikimi me ankuesin është realizuar nëpërmjet specialistes së Zyrës Rajonale Fier të KMD-së.

3. Nëpërmjet procesverbalit të datës 20.04.2021, mbajtur në Zyrën Rajonale Fier, të KMD-së ankuesi ka konfirmuar se është njohur me përgjigjen dhe dokumentacionin e dërguar nga Bashkia lidhur me pretendimet e tij.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë të pretenduar nga ankuesi.**

- a) Lidhur me trajtimin e padrejtë të pretenduar nga ankuesi, përsa i takon mospërfitimit të ndihmës ekonomike, nga ana të Bashkisë.

Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, familjet pa të ardhura dhe me të ardhura të pamjaftueshme dhe kategoritë e tjera mund të aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike pranë njësisë vendore ku kanë vendbanimin.

Një ndër kategoritë që mund të përfitojnë ndihmën ekonomike, janë edhe familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Procedura që duhet ndjekur dhe zbatuar lidhur me përfitimin e ndihmës ekonomike është përcaktuar në mënyrë të detajuar në VKM-në sipërcituar. Kështu:

Për të përfituar ndihmë ekonomike kryefamiljari apo bashkëshortja, nga data 1-10 të çdo muaji duhet të paraqiten pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/njësitë për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në nevojë me kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti (për fëmijët certifikata) dhe dokumente të tjera të përcaktuara në aktet nënligjore.

Administratori, në prani të kryefamiljarit, bashkëshortes apo individëve plotëson on-line në sistem aplikimin për ndihmë ekonomike të cilët përmbledhin informacionin për: demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; llojin e banesës; pasuritë/asetet shtëpiake; të ardhurat nga programet e mbrojtjes sociale. Lista e familjeve aplikante verifikohet automatikisht nga sistemi elektronik me të gjitha institucionet dhe pasi përfundon ky verifikim në lidhje me saktësinë e informacionit merret vendimi për këto familje.

Vendimi për trajtimin me ndihmë ekonomike merret brenda muajit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror nëpërmjet formulës së pikëzuar që përfshin parametra të lidhur me vlerësimin e situates ekonomike të familjeve, të tilla, si: kushtet e jetesës, zotërimi i pasurive, të ardhurat nga remitancat. Formula e pikëzuar merr parasysh karakteristikat e ndryshme strukturore të familjeve urbane dhe rurale.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social dërgon vendimin final së bashku me listën e familjeve fituese me masën e përfitimit dhe familjet jopërfituese me arsyet përkatëse kryetarit të njësisë vendore për të njoftuar të gjithë aplikantët dhe për të bërë ekzekutimin e pagesës.

Për të gjitha familjet përfituese është e detyrueshme paraqitja çdo 3 (tre) muaj tek zyra e administratorit shoqëror i cili plotëson deklaratën social-ekonomike dhe e hedh në sistem si dhe verifikon gjendjen shoqërore dhe ekonomike të familjeve në nevojë, kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Mosparaqitja një herë në 3 muaj dhe moslejimi i verifikimit social-ekonomik në familje largon familjen nga skema e ndihmës ekonomike. Familjet të cilat janë refuzuar se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme kanë të drejtën e riaplikimit në muajt pasardhës dhe gjithashtu ruajnë të drejtën e ankimimit në lidhje me vendimin e marr.

Për sa më lart, bazuar në dokumentacionin e depozituar pranë KMD-së, nga ankuesi dhe Bashkia, rezulton që z. Xh nuk është paraqitur pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/njësitë për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në nevojë, që nga muaji maj i vitit 2017.

Pretendimi i ankuesit se në muajin shkurt 2020 ka aplikuar pranë Bashkisë për përfitimin e ndihmës ekonomike, nuk qëndron, pasi ai ka paraqitur ankesa lidhur me faktin që nuk përfiton ndihmë ekonomike nga viti 2017 e aktualisht, por nuk ka aplikuar sipas orientimit të Bashkisë<sup>6</sup> dhe procedurës së përcaktuar në VKM-në sipërcituar.

Nga aktet shkresore të vëna në dispozicion, rezulton që Bashkia Fier i është përgjigjur kërkesave/ankesave të subjektit ankues, si dhe e ka orientuar atë lidhur me hapat që duhet të ndjekë për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Nga ana tjetër, ankuesi është njohur me qëndrimin e Bashkisë, si dhe dokumentacionin e sjellë prej saj pranë KMD-së, dhe nuk ka arritur që të provojë të kundërtën e tyre, me fakte apo dokumentacion provues.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë apo të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Fier.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Fier, lidhur me mospërfitimin e ndihmës ekonomike, për shkaqet e pretenduara nga subjekti ankues.

- b) Lidhur me trajtimin e padrejtë të pretenduar nga ankuesi, përsa i takon mospërfitimit nga programet e strehimit, nga ana e Bashkisë.

---

<sup>6</sup> Referuar shkresës nr. 769/1 prot., datë 03.02.2021 dhe shkresës nr. 2084/1 prot., datë 12.03.2021, të Bashkisë Fier.

Kushtet, procedurat dhe dokumentacioni për të përfituar nga programet e strehimit social përcaktohen duke u bazuar në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, si dhe VKM nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

Sipas këtyre akteve, programet e strehimit social përfshijnë: subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, subvencionimin e interesave të kredisë dhe grantin e menjëhershëm për banesa me kosto të ulët.

- Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë është një instrument financiar në zbatim të programit “Banesa sociale me qira“, me anë të së cilit mbështeten individë/familje me të ardhura të pamjaftueshme dhe nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë. Masa e subvencionit të qirasë përcaktohet në varësi të të ardhurave të aplikuesit dhe numrit të anëtarëve të familjes dhe mund të jetë deri në 100% të qirasë mesatare të miratuar në këshill bashkiak, sipas një formule të përcaktuar në VKM-në përkatëse. Për të përfituar subvencionin e qirasë përfituesi duhet të dorëzojë brenda afateve të përcaktuar në ligj kontratën e qirasë dhe vlera e subvencionit i paguhet drejtëpërdrejtë qiradhënësit ndërsa qiramarrësi ka të drejtë për të përdorur banesën me qira.
- Subvencionimi i interesave të kredisë jepet për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët dhe jepet për ato familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesat e kredisë të ofruara nga institucionet financiare për blerjen e një banese me vlerë jo më të madhe se mesatarja e vlerave të tregut në NJVV dhe me sipërfaqe jo më të madhe se normat e strehimit të përcaktuara.
- Granti i menjëhershëm është një instrument financiar që lehtëson pagesën e banesave me kosto të ulët për ato individë/familje që plotësojnë kriteret ligjore. Shuma e grantit të menjëhershëm, që përfiton individi, është në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.

Procedurat për të përfituar nga programet sociale të strehimit si dhe kushtet që duhen plotësuar për të përfituar nga njëri prej tyre, janë të ndryshme dhe specifike për secilin.

Pretendimi i ankuesit se në muajin tetor 2020 ka aplikuar pranë Bashkisë për përfitimin nga skema e programve të strehimit, nuk qëndron, pasi ai ka paraqitur ankesa lidhur me faktin që nuk përfiton strehim nga ky program nga viti 2017 e aktualisht, por nuk ka aplikuar sipas orientimit të Bashkisë<sup>7</sup> dhe procedurës së përcaktuar në VKM-në sipërcituar.

Nga aktet shkresore të vëna në dispozicion, rezulton që Bashkia Fier i është përgjigjur kërkesave/ankesave të subjektit ankues, si dhe e ka orientuar atë lidhur me hapat që duhet të ndjekë për përfitimin nga njëri prej programeve të strehimit.

---

<sup>7</sup> Referuar shkresës nr. 2084/1 prot., datë 12.03.2021, të Bashkisë Fier.

Lidhur me sa më lart, për të përfituar nga njëri prej këtyre programeve të strehimit, ankuesi duhet të paraqitet pranë zyrës përkatëse të Bashkisë Fier, të aplikojë dhe të dorëzojë dokumentacionin e përditësuar, sipas kushteve e kriterëve të programit ku do të aplikojë.

Të gjitha familjet, të cilat aplikojnë për të përfituar nga programet e strehimit, kanë detyrim ligjor të plotësojnë dhe të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin administrativo-ligjor sipas kërkesave që parashikon ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, dhe VKM nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

Në këto kushte, subjekti ankues, duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore sipërcituar dhe t’i dorëzojë pranë Bashkisë Fier.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë apo të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Fier, dhe në mungesë të një trajtimi të tillë, nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese kundrejt ankuesit, për shkaqet e pretenduara prej tij.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 3, pika 1 dhe 3, nenin 7, pika 1, nenin 11, nenin 32, pika 1, germa a) dhe, nenin 33, pikat 9 dhe 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, nga ana e Bashkisë Fier, për shkaqet e pretenduara prej tij.
2. I rekomandohet subjektit ankues të aplikojë për përfitimin e ndihmës ekonomike nga data 01 deri më datë 10 të çdo muaji pranë Njësisë Administrative ku banon, si dhe të plotësojë dokumentacionin e kërkuar për të përfituar strehim nga programet e strehimit pranë Bashkisë Fier.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Të mira dhe shërbime  
Shkaku: “Bindjet politike”, “Gjendja ekonomike”  
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim